



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e kuvendit komunal të Rahovecit, e mbajtur më **30.08.2022.** me fillim në ora **10:00.** Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i kuvendit z.**Defrim Kafexhiu.** Konstatohet se kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi:

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes, i nderuar kryetar i komunës z. **Smajl Latifi**, nënkryetar i komunës z. **Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit, kjo është seanca e tetë për këtë vit **kalendariq**.

Atëherë KPF në mbledhjen e mbajtur më 19 gusht 2022 pas shqyrtimit të pikave të rendit të ditës që janë propozuar nga kryesuesi i kuvendit në koordinim me kryetarin e komunës, ka propozuar këtë rendi dite me 11 pika;

REND DITE

Njësia Nr./Br./No 01/Kuvendi i Komunës

Nr./Br./No 371 Nr. i faq./Br.str./No.pg 01

Data/Datum/Date 23.09.2022

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2021;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve dhe lagjeve në komunën e Rahovecit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e P-71510057-0234-2 në zonën kadastrale Rahovec;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P-71510057-05864-0 zona, në kadastrale Rahovec;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P- 71510057-05864-0 zona, në kadastrale Rahovec;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P- 71510021-00010-1 dhe P-71510021-00010-2, në zona kadastrale Dobidol;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P- 71510021-00010-1 dhe P-71510021-00010-2, në zona kadastrale Dobidol;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.337/22, i datës: 29.06.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.339/22, i datës: 29.06.2022 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.

Kryesuesi – Poashtu ka ardhur edhe një ftesë në emër të drejtorit të festivalit “HARDHFEST” – “HardhTalk” është një format i ri konferencash brenda festivalit që ka qëllim trajtimin e temave të ndryshme në interes të publikut dhe në bashkëbisedim aktiv ndërmjet folësit dhe pjesëmarrësve tjerë në konferencë. Me datë 2 shtator, ora 10 në sallën e kuvendit komunal, tema do të jetë; “Brendimi i një vendi me potencial turistik dhe trashëgimi kulturore”. Si përfaqësues të qytetarëve e kanë parë të arsyeshme të na ftojnë edhe neve në këtë konferencë duke dhënë kontribut apo të shkëmbejmë ide rreth kësaj teme.

Sejfulla Sejfullahu – Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtor, kolegë asambleistë, media dhe ju shoqëri civile. Sot është 30 gushti, dita ndërkombëtare e të zhdukurve dhe pasi vij prej në vendbanimi që ka shumë të zhdukur dhe akoma edhe 64 do të kisha dashur që seancën ta fillojmë me një minut heshtje pa dashur të paragjykoj nëse ata janë të vrarë apo të gjallë, por në shenjë të veprimtarisë së jetës së tyre. Gjithashtu ju informoj që në ora 19:00 në Krushë të Madhe kemi nderime për të pagjeturit duke ndezur për secilin të zhdukur një flakadan për të stimuluar punën për të bërë më shumë për të pagjeturit. Kisha patur dëshirë që tani e tutje 30 gushti të jetë në agjendë në komunë, e di që për nderime keni bërë çdo herë çdo gjë, aryeja e parë është që uroj që sa më parë t’i gjejmë të gjithë të zhdukurit e që më pas nuk është nevoja për shënimin e kësaj date, e dyta; Meqenëse nuk kemi ende këshill të fshatit, brenda mundësive ligjore kërkoj që prej këtij viti kjo datë të bëhet si agjendë e komunës.

Kryesuesi - Faleminderit Sejfullah, atëherë ju ftoj të gjithëve të ngritemi në këmbë për një minut heshtje. ... nderim dhe respekt të gjithë të zhdukurit në ditën ndërkombëtare të të zhdukurve, nderim dhe respekt edhe për familjarët e tyre që presin për fatin e të zhdukurve nga lufta e fundit në Kosovë.

Kryetari – Faleminderit kryesues, nënkryetar, drejtorë, anëtarë të kuvendit, përfaqësues të mediave, të KFOR-it, shoqëri civile. Po, unë jam dakord që 30 gushti të nderohet, të respektohet përmes simbolikave që zakonisht janë bërë traditë në Krushë të Madhe, patjetër që do të jem sonte aty bashkë me të tjerët. T’u fusim në kalendarin e ngjarjeve ndoshta është pak vështirë se mund të kemi situatë ndryshe në të ardhmen dhe sigurisht që ne jemi të interesuar që të punohet që sa më shpejtë për zbardhjen e fatit të të pagjeturve edhe në qoftëse zbardhet kjo ditë, ne jemi të interesuar t’u respektojmë dhe nderojmë këtë ditë. Sa i përket këshillit të fshatit që është shumë e nevojshme e dobishme dhe e domosdoshme që Krusha e Madhe t’u ketë një këshill të fshatit, i inkurajoj edhe Sefën edhe Arbërin dhe të gjithë krushianët që një ditë t’u ftojnë komisionin sa më shpejtë, t’u zgjedhin edhe kryetarin edhe këshillin e fshatit sepse Krusha e Madhe meriton t’u ketë këshillin e fshatit dhe kryetarin. Lap-topët e dhuruar që janë blerë me buxhet të komunës së Rahovecit për anëtarët e kuvendit, së pari do të regjistrohen dhe rrjedhimisht shfrytëzohen nga asambleistët deri në fund të mandatit, në fund të mandatit mund të shihet më saktësisht se çka vendosë kuvendi i komunës dhe ekzekutivi, jemi kundesur me përgjegjësit e IT, Dritanin edhe Petritin që t’i plotësojnë ato standarde dhe kritere të viteve të fundit, urime dhe faleminderit.

Kryesuesi – Një kërkesë nga zyra e IT për antëtarët e kuvendit, emailin që iu kanë dërguar në fillim të mandatit për dërgimin e të dhënave, për krijimin e emailave zyrtarë për anëtarët e kuvendit – fotot dhe të dhënat tjera personale për përditësimin e web-faqes së komunës për anëtarët e rinjë të kuvendit. Ju lutem që t’i dërgoni në emailin e njërit prej zyrtarëve të IT së kuvendit ose në sekretari të kuvendit... Nëse dikush prej anëtarëve ka ndonjë propozim rreth rendit të ditës?... Atëherë pas dorëheqjes së anëtarit të kuvendit Samir Mustafa, kemi një anëtarë të ri në këtë seancë, e ftoj anëtarin më të ri të kuvendit z. Drilon Mustafa për betim.

Drilon Mustafa – Përshëndetje, unë Drilon Mustafa betohem që do t’i kryej me nder, besnikëri pa anime me ndërgjegje sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i kuvendit të komunës së Rahovecit, në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë të qetë për të gjithë. Faleminderit.

E shfrytëzoj rastin t'a përshëndes kryetarin e komunës z. Smajl Latifi, kryesuesin z. Kafexhiu, të gjithë drejtorët e drejtorive komunale, drejtoreshat dhe njëkohësisht edhe juve kolegë.

Kryesuesi – Të priftë e mbara në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të kuvendit... Nëse dikush nuk ka ndonjë çështje tjetër apo ndonjë propozim, po e vendosim në votim miratimin e rendit të ditës. Kush është për? ... Me shumicë votash aprovohet rendi i ditës për ditën e sotme.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Ndonjë kërkesë, sygjërim rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim pikën e parë të rendit të ditës, kush është për?... kundër?... abstenim?... Me shumicë votash për, aprovohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;

Dikush prej anëtarëve të kuvendit ndonjë çështje?

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues, kryetar i nderuar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë, shoqëri civile. Për ekzekutivin apo drejtorinë përkatëse të shërbimeve publike një çështje nga qytetarët e fshatrave Brestov, Hoqë e Vogël, Nagac, Krushë e Madhe për shenjëzimin e rrugës që i lidh këto fshatra, prej Rahovecit në Krushe të Madhe e di që rruga është rajonale dhe si e tillë duhet të trajtohet nga ministria e infrastrukturës, mirëpo drejtor, a mund t'a iniconi ndonjë kërkesë specifike për këtë çështje. Çështje tjetër, është ndriçimi publik; projekti që tani ka filluar dhe është implementuar në fshatin Hoqë e Vogël dhe Brestoc, kur do të vazhdoj projekti për fshatin Nagac dhe një pjesë të fshatit Brestoc?... Çështje tjetër është edhe për disa tabela për njoftime për këto fshatra, ku fillojnë fshatrat, kjo pjesë nuk e ka dhe a duhet kjo kërkesë të trajtohet nga ministria apo mund t'a bëni ju si drejtori.

Burim Krasniqi - Faleminderit kryesues, përshëndetje për kryetarin, drejtorat, kolegët asambleistë dhe gjithë të pranishmit këtu në sallë. Si grup i asambleistëve kemi disa kërkesa; E para nga drejtori i financave, meqenëse besoj që muaji shtator do të jetë muaji i buxhetit të komunës së Rahovecit, po kërkojmë për të disatën herë që para se të vijë buxheti në kuvend, t'a kemi një listë të obligimeve të cilat i bartë komuna e Rahovecit ndaj operatorëve, obligimet që janë të projekteve të përfunduara por të pa mbuluara financiarisht dhe projektet që janë në zhvillim që e kanë vitin e fundit të implementimit sipas ligjit të prokurimit që kontratatë iu njeh 3 vite dhe jo më shumë. Por në anën tjetër të KAB-i që është pjesë e buxhetit, t'i kemi edhe projektet që tejkalonë këtë vit d.m.th nuk janë vitin e fundit dhe kur të vijë buxheti të mos ndalemi në imtësira të caktuara por t'a gjejmë një konsensus të përbashkët të implementimit të buxhetit sepse çdo votë kundër në një farë forme shkon në kurriz dhe dëm të qytetarëve dhe jo në dëm të asambleistëve, grupeve të caktuara, si e tillë mendoj që është shumë e rëndësishme, kam prit që sot të kemi një informim zyrtar prej drejtorisë së financave rreth obligimeve që i ka komuna e Rahovecit, çoftë borgjit, çoftë obligimeve kontraktuale me qëllimin e vetëm që mos të kemi mospajtime të mëdha rreth buxhetit por mund të kemi mospajtime për ndonjë projekt specifik që duhet shtyer tutje. E dyta, nuk dua të paragjykoj, kam informacione që ka staf arsimor që pranohen me gjysë norme, ndërkohë që ka arsimtar tjetër që kanë tjetër lëndë gjysë norme, drejtori i DKA-së nuk qenka këtu, besoj që e merr pyetjen prej administratës. Kërkesë e grupit të asambleistëve të LDK-së është që të kemi një informatë – përgjigje në pyetjen që e parashtrijmë; Sa arsimtarë i kemi me gjysë norme të lëndës së njejtë dhe periudha e pranimi në punë të këtyre arsimtarëve?... Nuk besoj që as kryetari i komunës as dikush tjetër janë të kënaqur me cilësinë në arsim, pavarësisht angazhimit që mund të ketë komuna ose secili prej neve, por besoj që së paku duhet të jemi të kujdesshëm në raport me stafin arsimor sepse kur ka me gjysë norme, pranojmë përsëri me gjysë norme, ne vetëm i shkaktojmë dëm cilësisë në arsim në komunë të Rahovecit pavarësisht objekteve që mund të jeni të bukura ose të reja, po presim që të kemi një informatë në këtë drejtim; Periudha e pranimi të arsimtarëve dhe numri i orëve që e kanë në nivel të komunës së Rahovecit. E treta kryetar, është shqetësuese kur një fshat si Krusha

e Madhe nuk mund t'a zgjedh këshillin e fshatit, ka diçka më shumë se sa një mosgatishmëri të një individi ose dy. Përpos asambleistëve të Krushës edhe ju si kryetar komune ose edhe kushdo tjetër që mundet t'a shoh pse po ndodhë kjo, në bazë të bisedës që kam patur me anëtarët e komisionit nuk ka patur vullnet të madh për marrje të përgjegjësisë si kryetar i fshatit pothuajse në asnjë vend, është pak shqetësuese, duhet gjetur formula ose metoda se si ata të ndihen mirë dhe si një këshill i fshatit të jetë faktor në proceset vendimmarrëse për fshatin e vet që së paku shpirtërisht të ndihet mirë dhe t'a sheh veten të rëndësishëm për përgjegjësitë që i merr. Ta shohim mundësinë që mos t'i degradojmë sepse rruga më e lehtë e komunikimit me banorët e fshatit ose lagjeve është përmes këshillit që mund t'i ketë komuna sot dhe në të ardhmen.

Edona Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë, i nderuari kryetar, kolegë asambleistë, drejtorë të drejtorive, të gjithë pjesëmarrësit në këtë seancë. Unë e kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike; Si qëndron mirëmbajtja e rrugëve dhe sa herë në vit mirëmbahen?... Kemi edhe një kërkesë të fshatit Pataqan të Epërm, ka tash e tre vite që kanë probleme serioze me rrugë dhe fare nuk është ndërmarrë asgjë nga komuna.

Sejfullah Sejfullahu – Deshta t'a pyes kryetarin, se kur është planifikuar të mbahet "Agro-Festa"?...

Kryetari – Faleminderit shumë për kontributin, po përpiqem të jap sqarime rreth çështjeve që i ngriti Burim Krasniqi. Patjetër që obligimet kontraktuale dhe financiare do t'i paraqesim dhe besoj që drejtorja e financave nuk e ka problem dhe besoj që sipas udhëzimit administrativ dhe rekomandimeve që i kemi marrë nga organizatat monitoruese, me 1 shtator do t'a keni listën e projekteve kapitale të gjithë anëtarët e kuvendit me çrast ndodh për herë të parë në historinë e qeverisjes në komunën tonë. Ne çdo muaj e kemi barazimin në ministrinë e financave, raportimin tremujor, gjashtëmujor por edhe këtu mund t'a bëjmë dhe të kemi çasje më serioze, mirë që e keni bërë këtë kërkesë, së paku deri më tani nuk ka patur kërkesë zyrtare të tillë. Te afatet e kontratave; Ne kemi kontratë 1 vjeçare, 2 vjeçare, 3 vjeçare dhe neve na lejohet me ligj vazhdimi i sigurimit të ekzekutimit të kontratave dhe këtu duhet të jemi të kujdesshëm sepse e kemi rekomandim nga ZKA (Zyra kombëtare e auditimit) pra, mund të vazhdohet kontratat, ndryshe nuk ka logjikë, po supozojmë që është ndërprerë puna e rrethrotullimit në Xërxe, kontrata dhe kodi ekziston, kanë kaluar vite, por sigurisht nëse duhet të vazhdohet ajo kontratë, vazhdohet me patjetër siguri i ekzekutimit të asaj kontrate, të gjithë e kuptojnë por Burim, ti e kupton më mirë se çka po flas. Te arsimtarët me gjysëm norme, drejtori sot është në mbledhje të MASHT-it për pregatitjen e fillimit të vitit të ri shkollor, janë të gjithë drejtorët e arsimit dhe asociacioni i komunave që e kanë patur obligative të shkojnë në takim. Po përpiqem t'i jap disa shpjegime parimore, pa dashur të hyj në detaje. Ne edhe nëse dëshirojmë të shpallim konkurs, neve nuk na lejohet të shpallim konkurs kur kemi me gjysëm të profilit të asaj lënde që kërkohet, konkursi në këtë rast anulohet. Ne e kemi detyrim ligjor t'i plotësojmë normalet e atyre që punojnë, ndërsa ka raste, po flas parimisht, që dikush e ka normën jo të plot, e dikush tjetër përtej të plotës, kjo përshkak të mungesës së profileve që i përgjigjen. Ka këso diskrepanca, por të siguroj që konkurs nuk guxojmë të hapim edhe në qoftëse i kemi normat e paplotësuara e që kemi mundësi t'i plotësojmë. Besoj që për të gjitha këto paçartësi, DKA do të jep përgjigje zyrtare saktësisht për të gjitha. Te këshillat e fshatit, asnjë kryetar i këshillit të fshatit ose i këshillit të lagjeve urbane të qytetit nuk janë paguar sepse nuk kemi gjetur modalitet t'u japim pagë, secili kryetar është kompenzuar me mëditje kur janë ftuar, madje disa i kanë refuzuar për arsye personale, sepse ka prej tyre që janë veteran dhe nuk ka dashur të merr mëditje sepse është friguar që rroga e veteranit i ndalet. Sa i përket këshillit të fshatit në Krushë të Madhe, në qoftëse për ndonjë kryetar të fshatit është gjetur modaliteti i kompenzimit, ai është Selami Hoti edhe këtë nuk e fsheh sepse kemi arritur t'i ndihmojmë gjithashtu edhe ai komunës tone një here si coordinator për të zhdukur në një periudh të caktuar dhe një here si përgjegjës për rrefimet gojore nga të mbijetuarit e masakrës. Pra, Selami Hoti ndoshta nuk e ka gatishmërinë për kandidim përsëri, por përsëri po them që jam i interesuar që Krusha e Madhe ta ketë kryetarin dhe këshillin e fshatit, duke gjetur një rrugë sa më të shpejtë. Sidoqoftë ne si kuvend mund t'a gjejmë një modalitet shumë shpejtë

duhet bërë një rregullore vitin e ardhshëm dhe t'i inkurajojmë me ndonjë pagë. Edona Kryeziu, nuk dua të të përgjigjem tani, e kemi Përparimin nëse vlerëson mund të jep përgjigje edhe për rrugën rajonale. Te Sejfullah Sejfullahu... Agro-festa, ka një tendencë që këtë vit të organizohet pak më ndryshe sepse nuk është vullneti se si është organizuar viteve të kaluara dhe ka një përpjekje të vendoset në qendër të fshatit. Përkundër Hardhfestit që sigurisht ka me qenë një ngjarje e madhe, me verë, me diplomatë, me këngëtar ndërkombëtar, turist të huaj, është mbretëresha e rrushit, shtrydhja e rrushit e shumë aktivitete tjera, ndërsa te Agro festa, t'a shohim një modalitet deri më 15 shtator do të bëhet një zgjidhje sepse jemi të interesuar t'a ruajmë traditën e festivalit dhe të mbetet si i tillë që jep peshë dhe rol si dhe pasqyrim i mirë i asaj se çka ndodh në komunën tonë.

Besmire Bytyqi – Faleminderit shumë, i nderuar kryetar, kryesues, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë. Unë e kam shqetësim; te ndërtesat e kuqe te “Hareja” të gjithë e dijmë se ku janë këto ndërtesa, aty ka kohë që kemi probleme me oxhaqe, pyetja është për drejtorinë e urbanizmit, jemi duke shkuar te sezona e dimrit dhe n'a duhet urgjentisht të ndërmarrim masa dhe të shikojmë se çfarë problemi ka dhe çka mund të bëjmë si komunë-institucion për lirim të atyre oxhaqeve, që dimrit mos të kemi telashe sepse të gjithë e dijmë që aty mund të ketë rrezik të ngulfatemi nga tymi.

Sejfullah Sejfullahu – Nuk e kam ndërmend kryetarit t'i bëjë replikë sepse na ka bërë me laptopa, bile ky i imi qenka “trefazë”. Faleminderit për shqetësimin kryetar, për këshill të fshatit. Faleminderit edhe Burimit që e ngriti çështjen. Kryetar, disa gjëra që i the ti nuk i kam ditur, por është mirë me bë një modalitet, pa dashur t'i jap karakter lokal por nuk është njëjtë me qenë kryetar i Krushës së Madhe sikur kryetari një fshati që i ka 20-30 shtëpi, jo përshkak të numrit të banorëve, por specifikave që i përmende edhe vet, mos të harrojmë që në Krushe të madhe nuk kalon java që vie dikush e që kryetari duhet t'a pres, po them kushtimisht. Kanë qenë kryeministra, presidentë, gazetarë, personalitete, deputet etj... Selamiu e ka kryer këtë punë deri tani, sa do që e kemi shok ai nuk e ka të lehtë që mysafirët t'i dërgoj nëpër dreka e darka e t'i pres. Nuk është e pamundur t'a bëjmë një kryetar të fshatit, por gjithmonë mendojmë të bëjmë më të mirën sepse është nevoja aty të jetë dikush vazhdimisht. Duhet ta gjejmë një formë sepse ne kemi biseduar edhe privatisht, nuk dua t'a keqpërdori këtu por e di që keni vullnet edhe duhet të bëni zgjidhje. Sa i përket “Agro-festës” mirë është t'a vazhdojmë traditën sepse ne kemi filluar qashtu me sy mbyllur, e kemi nisur me një ose dy “tezga” e dikur e ka marrur edhe komuna nën patronatin e vet. Presim organizim më të mirë edhe pse ka hipur gjithçka, nafta e shumë gjëra tjera, në e kemi organizuar edhe gjatë pandemisë shumë mirë, sivjet presim shumë më mirë, 24 orë kemi në dispozicion vetëm për të mos e humbur traditën.

Burim Krasniqi – Kërkoj falje për shkelje të rregullores në raport me minutazhën, por pata një shqetësim. Samir Mustafa paska dhënë dorëheqje prej asambleistit, besoj që prezenca e tij është e rëndësishme duhet shikuar përvojën e tij si asambleist, a ka ndonjë arsye specifike, pa dashtë t'a paragjykoj asambleistin që e dha betimin, me të cilin njifemi personalisht, por ku është problemi me këtë dorëheqje, mendoj që Samiri ka mundur mjaftueshëm t'i jep asamblesë komunale me përvojën që e ka çoftë si drejtor, çoftë si asambleist.

Kryetari – Sefë, “Agro-festa” do të mbetet dhe do t'i shohim modalitetet e organizimit më të mirë këtë vit, pa dashur të keqpërdoret edhe një herë po them, secili kryetar fshati e ka kryer punën e vet, Selamiu ka patur ngarkesë shumë të madhe, dua të them që nëse ndokush është trajtuar financiarisht me respekt, mundësitë i kemi patur t'a trajtojmë Selamiun, për shkak të situatës në të cilët gjendet Krusha e Madhe. Duhet t'a gjejmë një modalitet, ndoshta si Peja, që e ka gjetur një mënyrë, duhet t'a shohim se çka kanë bërë ata në këtë drejtim. Samiri është shëndosh si molla, përvojë ka patur si drejtor e në asamble nuk i ka pëlqyer të qëndroj, po punon- është shërbyes civil, zyrtar ligjor është, keni qenë në dijeni edhe ti Burim, por nuk ka asgjë të keqe në këtë muhabet. Në vend të tij është Driloni, një entusiast që nuk e ka pasë të qartë që sot e ka vetëm

betimin, përndryshe është arkitekt i mirë dhe punon shumë. Për aktivizëm në kuvend kemi me pas Drilonin, Samiri ka folur shumë rrallë.

Te Besmira; anëtarë të nderuar të kuvendit ju e dini që ministria e financave në kuadër të fondit rezervë, në mesin e atyre projekteve ka hequr edhe kodin e fasadimit, pra sivjet ne nuk kemi patur të drejtë të bëjmë asgjë në fasadim apo eficiencë të objekteve të banimit. Në vitin e ardhshëm kemi paraparë që të kemi fasadim dhe eficiencë të objekteve publike. Për oxhaqe, “ju nuk e di a jeni në dijeni që prindi i Hasan Përboqit është një specialist për këto gjëra, meqenëse jetojmë me qira aty, ne mundemi t’a paguajmë për zhbllokimin e atyre oxhaqeve, para dimrit vetëm duhet t’ia bëjmë disa para gati”

Merisa Sharku – Përshëndetje për të gjithë, e mora fjalën t’a ngris një çështje mjaftë me rëndësi, sheshi në qendër të qytetit, kur une e kam ngritur këtë çështje në kuvend përveç që kam bërë analizë rreth projektit, kërkesa ime kryesore ka qenë që të bëjmë konsultime me shumë rreth këtij projekti përveq atij me qytetarë, e kam potencuar që duhet të diskutojmë edhe me ekspert të fushës përkatëse. Projektet me kaq rëndësi të madhe nuk bëhen në këtë mënyrë. Projektet ideore studentore që i kemi bërë gjatë studimeve besoj kanë përbajtur më shumë analiza rreth projektit sesa ky projekt i komunës që është bërë për këtë pjesë kaq të rëndësishme të qytetit. Kur kam bërë propozim për shqyrtim më të thellë jeni thirrur në afate ligjore, projekti ideor mund të jetë për nguti, por projekti zbatues asesi. Kështuqë kishte me qenë më e udhës që projekti zbatues të ishte shtyer pak sepse duhet t’i mendojmë gjërat pak më gjatë. Shkaku i këtyre problemeve rrjedhimisht vijnë ankesat e banorëve, nuk e di sa keni informatë por shumica e banorëve po e kundërshtojnë këtë projekt, sepse shumica prej tyre nuk e kanë patur as informatën minimale për këtë gjë. Është thirrur një herë një dëgjim publik, por edhe atëherë e kam potencuar që dëgjimet publike të thirrura në faqe në facebook, nuk rezultojnë të suksesshme. Aty po bohet një tollovi shumë e madhe ende pa filluar mirë zbatimin e projektit dhe gjatë dëgjimit publik që kam qenë atëherë aty në hyrjen e një lagje që ka shumë shtëpi, ka qenë propozimi që rruga të bëhet njëkahëshe, a po mbetet të bëhet një kahëshe apo si?... Pyetje tjetër i drejtohet drejtorit për shërbime publike, ka të bëjë për një rrugë në qendër të qytetit, rruga “Fahredin Hoxha” ata thonë që kjo rrugë ka dalur prej funksionit totalisht, aty përveç që është bërë rrugë e pakalueshme, janë të dëmtuar edhe gypat e kanalizimit, me çrast kanalizimi po del në sipërfaqe dhe po futet nëpër oborret e shtëpive nëpër lagje. Rreziku më i madh shfaqet kur ka reshje sado të vogëla, rrezikohen shtëpitë nga përmblytjet dhe është mirë që ky problem të zgjidhet para dimrit sepse aty janë diku rreth 15 familje që banojnë dhe rruga është e pakalueshme për automjete dhe kanalizimi është i dëmtuar tejmasë.

Kryetari – Faleminderit shumë, për sa i takon çështjes që e paraqiti Merisa Sharku, diskutimet publike kanë ndodhur me proflin e profesionistëve, janë njoftuar edhe bashkësitë fetare, artistët, Merisa poashtu me kapacitetet profesionale ka qenë pjesë e këtyre debateve, ka qenë edhe Burim Krasniqi, kemi tentuar t’i ftojme ata që kanë dije dhe profesionalizëm në këtë drejtim, patjetër që shqetësimet e banorëve që i kemi marrur në konsideratë, zakonisht shqetësimet e banorëve të apostrofuar vijnë kur fillon implementimi sepse zakonisht nuk marrin pjesë nëpër takime. Aty shqetësohet ata që shesin mallra, që kanë marrur dënime dhe do të marrin përsëri, janë dy dyqane që ekspozojnë mallra në kundërshtim me rregullat e kuvendit dhe aty ngushtohet rrethi goxha shumë, madje kam kërkuar edhe publikisht dyqanet në fjalë të mbyllen krejtësisht. Sa i përket pyetjes së Merisë, a do të jetë rrugë njëkahëshe apo dykahëshe, kur të përfundon e gjitha ne përsëri do të flasim edhe për shenjëzimin dhe do të rikonsiderohet a janë mundësitë të bëhet një kahëshe apo të jetë dy si tani. Diskutimet publike të kësaj natyre, janë të nevojshme dhe të dobishme dhe detyrime ligjore, besoj që do të del një projekt shumë i mirë në atë hapësirë dhe sipërfaqe që e ka ajo pjesë.

Merisa Sharku – Kam ndëgjuar që pjesa tjetër e trotuarit ose ana e kundërt me sheshin do të zgjerohet, a është e vërtetë? Sepse nëse mbetet kështu, është shumë problem nëse të njëjtë kohë vijnë dy mjete të mëdha, autobus ose kamion është pothuajse e pakalueshme, si bëhet zgjidhja?...

Kryetari – Po faleminderi Merisë, ne jemi duke e shqyrtuar mundësinë a duhet të jetë 6m apo të bëhet 7m jemi duke diskutuar dhe do të ofrojmë një zgjidhje teknikisht më të mirë. Qendra e qytetit dhe rruga kryesore që të qon te mella këtu edhe pesë rrugë të tjera do të trajtohen krahas asfaltimit të tyre do të trajtohen edhe për kanalizim të ujërave të zeza dhe atyre atmosferik.

Hasan Përboqi – Faleminderit kryesues, përshëndetje kryetar, kryesues, të nderuar kolegë asambleistë, drejtorë të drejtorive, media të pranishme dhe shoqëri civile. Kam një kritikë dhe një çështje për diskutim në lidhje me rrugët një kahëshe që janë bërë në qytet. Ka të bëjë me rrugën “Ibrahim Rugova” që është te parku i qytetit si dhe rrugën “Xhafer Nurkasa” që është ngjitur me shkollën fillore “Isa Boletini”. Drejtor, shumë mirë që janë bërë këto rrugë, sa kam qenë drejtor në mandatin e kaluar çdo herë kemi pas kërkesë që këto dy rrugë të trajtohen si rrugë njëkahëshme, një kritikë e vogël që është; në momentin që është vendosur që këto rrugë të jenë njëkahëshme, është dashur të bëhet një njoftim në media, të paktën qytetarët mos t’i zëmë të befashuar sepse ka pasur raste që qytetarët e kanë vazhduar qarkullimin si ka qenë më herët edhe pas shenjëzimit horizontal.

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryesues, përshëndetje kolegë drejtorë, të nderuar anëtarë të kuvendit, të pranishëm, monitorues. Do t’i përgjigjem Lirigzonit për pyetjen për rrugën rajonale; Sipas ligjit të transportit publik e rrugor, kompetencë ekskluzive është e ministrisë së infrastrukturës për vendosjen e shenjëzimit horizontal dhe vertikal, pavarësisht kësaj, unë çdo vit i ripërsëris kërkesat për shenjëzimin e rrugëve rajonale që janë në komunën e Rahovecit, rreth 7 rrugë rajonale që janë. Sa i përket tabelave njoftuese për fshatra, do t’a shqyrtojmë mundësinë, ne e kemi një kontratë për shenjëzim horizontal dhe vertikal, bashkë me drejtorin e financave sepse është menaxher i asaj kontrate, do t’a shqyrtojmë mundësinë e kapacitetit që së paku të vendosen shenjat për hyrje-dalje të vendbanimeve. Sa i përket ndriçimit publik, kemi bërë një ndriçim publik në rrugën rajonale prej 2.4km, mirëpo përshkak mungesës së buxhetit, nuk po kemi mundësi të bëjmë zgjerimin nëpër lagje tjera, por nëse kemi mbështetje financiare të këtij projekti, ne do të vazhdojmë sepse e kemi kontratën e hapur të zgjerimit të ndriçimit publik. Merisë, do të përgjigjem për çështjen e rrugës “Fahredin Hoxha” e kemi në kontratë, mos t’a përsëris atë që e tha kryetari, i kemi 6 rrugë në qytet, vlera e parashikuar është 1 milion euro, kemi një marrëveshje me ministrinë e infrastrukturës megjithëse është lidhur me vonesë, para një muaji, kemi shpallur procedurën dhe pritët që me 14 shtator të hapen ofertat për 6 rrugë në Rahovec do të ketë trajtim të ujërave fekale, atmosferik, riasfaltim të rrugëve d.m.th përfshihen të gjitha rrugët, 6 rrugë në qytet. Edona pyeti për çështjen në fshatin Pataqan, aty është një çështje që rrjedh uji i pijes nga Radoniqi, ka pasur dy ndërhyrje në rrugën kryesore dhe pavarësisht që e kanë për obligim K.R.U – Gjakova t’a ritrajton atë rrugë, nuk e kanë bërë këtë gjë, ne kemi bërë një marrëveshje me K.R.U – Gjakova duke bërë një ndërhyrje – trajtim, mirëpo ka probleme me ujë të pijshëm, nuk është problemi që komuna e Rahovecit nuk po i përmban ato rrugë, mirëpo fatkeqësisht K.R.U – Gjakova disa rrugë nuk po i trajton si duhet dhe nuk po i bën zgjidhje.

Afrim Berisha – Përshëndetje i nderuar kryesues, kolegë asambleistë, drejtorë të drejtorive, meqë je këtu, deshiroj të të pyes edhe për rrugën, segmenti Ratkoc – Vrajkë – Bratotin, një pjesë aty afër te Vrajkë është tepër e shkatërruar, qytetarët qarkullojnë me vështirësi të madhe. Një pyetje tjetër; mungesa e trotuarit për fëmijët që shkojnë në shkollë të fshatit Dejnë dhe Dobidol të cilët rrezikohet gjithmonë nga automjetet që kalojnë.

Burim Krasniqi – Drejtor, rruga “5 Maji” në Xërxe prej 2008 është e dëmtuar, mandate i tretë i juaji dhe një mandate i Idrizit dhe askush se ka prekë. A është për shkaqe politike apo parimore?...

Përparim Krasniqi – Mandati i tretë, por kurrë nuk i kemi trajtuar problemet me çështje politike sepse ligji na obligon të punojmë me çështje parimore, aty ka qenë asfaltim, duhet një trajtim të ri të asfaltimit të asaj rruge sepse jam në njohuri, nuk duhet t’a fshehim, për moment nuk kemi buxhet, kontratën e kemi të lidhur vetëm drejtorja e financave të siguroj mjetet, nesër niset puna për asfaltim në atë rrugë. Afrim Berisha, çështja e trotuareve; Ne e kemi filluar një pjesë të rrugës rajonale për trajtim të trotuareve, e kemi parë një

ndërtim që e kemi bërë prej Radostes në drejtim të fshatit Gexhë 605m të përfunduar dhe do të vazhdojmë edhe në pjesët tjera gjithashtu është në plan edhe ajo pjesa që u ngrit si çështje, do t'i shohim mundësitë financiare sepse është kontrata e madhe, rreth 14 km të planifikuar për ndërtim të trotuarëve dhe kërkesa është në të gjitha vendbanimet.

Leonard Morina – Përshëndetje kryesues, kryetar, ekzekutiv, kolegë asambleistë, të gjithë të pranishëm. Pata një pyetje për drejtorin e bujqësisë, meqenëse nuk është drejtori ndoshta kryetari mund të përgjigjet. Në fshatin Malësi të Vogël dhe Gexhë me datën 23 ka rënë breshër që ka bërë disa dëme në fushat bujqësore, bujqit kërkojnë të formohet një komision, të dalin në terren dhe t'a bëjnë vlerësimin e dëmeve. Ata thonë që kanë marrë përgjigje, që për shkak të grevave nuk formohen komisionet, por ata janë në hall të madh sepse duhet të pastrohen perimet për t'a marrur frutin e ri, por nuk guxojnë t'a pastrojnë për shkak se komisioni nuk mund t'a bëjë vlerësimin pasi që të pastrohet për shikim të gjendjes reale. Pyetja është, a do të ketë komision për këta bujqë, çoftë edhe emergjent për shkak të situatës që janë.

Kryetari – Faleminderit Leonard, është e vërtetë që administrata është në grevë, arsimi gjithashtu, ishalla nuk hyjnë edhe sektorët tjerë, kemi vështirësi shumë serioze, tjetër; përkundër këtij fakti, drejtori Berati i ka pranuar kërkesat dhe dokumentacionet, realisht ata duhet ta bijnë anëtarin e komisionit nga ministria për vlerësim, ne iu kemi drejtuar zyrtarisht, ky e ka pranuar dokumentacionin dhe ka formuar komision dhe zyrtarisht iu kemi drejtuar me një kërkesë që ata t'a caktojnë përfaqësuesit e tyre si anëtarë të komisionit, tash a duhet t'i vjelin specat apo jo, kjo ka qenë çështja që është diskutuar edhe me mua bashkë me kryetarin e fshatit, iu kam përgjigjur me; nuk e di, problemi qëndron se ne nuk kemi të drejtë të dërgojmë komision në terren. Ne e kemi dërguar, komisioni ka shkuar në terren, e kemi kërkuar edhe konfirmimin e ministrisë së bujqësisë dhe vlerësimin se sa % është dëmtuar, 90%, 60%, a duhet të hiqet të gjithë specat që janë dëmtuar potencialisht, ne nuk mund t'a dijmë përveç komisionit, po prapë ne nuk mund të marrim përgjegjësi dhe t'i themi atyre vjeli ose mos i vjel specat. Uroj që ministria e bujqësisë t'i kompenzojë dëmet e fundit në Malësi dhe Gexhë si dhe matanë drinit. Komisioni është duhet kryer punë shumë mirë dhe besoj që do t'a kemi një raport të përgatitur mirë dhe për masën e dëmit të shkaktuar do të vendosë komisioni duke e bërë raportin dhe e dërgon në ministri. Pra, kemi kryer punë edhe përveç faktik që ka grevë. Nuk e keni idenë se sa vështirësi kemi në administratë sidomos tash që po vijnë bashkatdhetarët e po udhetojnë, kanë nevojë dokumente e ne kujdesemi me respekt t'i kryejmë shërbime përkundër grevës.

Sejfullah Sejfullahu – Pak relaks kryetar, atëherë kur është fejuar Saranda kemi bërë festë këtu, Edona tash që është fejuar, shfrytëzoj rastin t'ia uroj fejesën Edona **Kryeziu**, urime.

Kryetari – Edhe une ia uroj fejesën Edonës, në emër të gjithë qytetarëve të komunës dhe bashkëpunëtorëve të mi.

Kryesuesi – Faleminderit, vazhdojmë te pika e tretë e rendit të ditës;

3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga raporti i auditimit nga zyra Kombëtare e auditimit për vitin 2021;

Afrim Limani – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, të nderuar asambleistë. Urime për lap-topët, i gëzofshi. Në momentin e pranimit të raportit final nga ana e zyrës së auditorit të auditorit me datë 17.06.2022 ne e kemi formuar një komision prej 11 anëtarëve për zbatimin dhe implementimin e rekomandimeve të dala nga ana e ZKA-së. Ky komision deri më tani ka mbajtur dy takime edhe pse sipas ligjit jemi të obliguar që një herë në tre muaj dhe gjithashtu e kemi dërguar në ZKA edhe planin e zbatimit të këtyre rekomandimeve. Në bazë të analizave të cilat i kemi bërë, konsideroj që nga 14 rekomandime, besoj që në fund të vitit fiskal prej këtyre 8 rekomandime do të zbatohen ndërsa 6 prej tyre pjesërisht. Derisa jam duke diskutuar këtu, shfrytëzoj rastin të jap një informatë ndoshta edhe jashtë rendit, sipas rregullave të reja të një udhëzimi të ri që ka dalë për shkak të performancës, ju do t'a keni sot buxhetin në emailat e juaja, pa investime kapitale, këto të fundit do t'i keni me 1 shtator.

Sejfullah Sejfullahu - Ne e kemi diskutuar edhe në seancën e kaluar rreth këtij raporti dhe për mua ka qenë absurde përderisa jemi komuna e parë dhe më transparente e që kemi marrur grante të ndryshme për këtë gjë, e në anën tjetër raporti i auditorit kombëtar ka qenë një "kijamet" në kuptimin e plotë të fjalës. I kisha thënë drejtorit që neve të na tregoni rezultatet e korrigjuara për të ardhmen, sepse nuk e di se çfarë vërejtje dhe sygjërimi mund t'a japim, kështu-ashtu nuk besoj që deritani janë përfshirë sygjërimet apo këshillat tona. Presim rezultatet edhe pse jemi opozitë i gëzohemi rezultateve të mira, granteve...

Kryesuesi – Faleminderit Sejgullah ... Atëherë po e vendosim në votim këtë pikë të rendit të ditës, kush është për?...kundër?...abstenim?... Atëherë me shumicë votash për, aprovohet pika e tretë e rendit të ditës, kalojmë te pika e katërt;

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve dhe lagjeve në komunën e Rahovecit;

Albnor Mullabazi – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, kryesues, të nderuar kolegë drejtorë, të nderuar asambleistë. Në mbështetje të nenin 12 pikës 1 dhe 2 të shkronjës D të ligjit të vetqeverisjes lokale të republikës së Kosovës kemi vendimin për formim të komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve dhe lagjeve në komunën e Rahovecit. Ky komision do të jetë prej 5 anëtarëve, 2 anëtarë nga ekzekutivi dhe 3 nga kuvendi i komunës.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, komisioni përbëhet prej 2 anëtarëve të ekzekutivit të cilët i kanë emrat sipas propozimeve të marrura nga ekzekutivi në KPF dhe 3 anëtarë të tjerë janë nga kuvendi komunal dhe i ftoj grupet e asambleistëve për propozim; me mirëkuptim, njëri prej grupeve të asambleistave nuk do të përfaqësohet në këtë komision t'a plotësojmë këtë numër prej 3 anëtarëve të kuvendit, fillimisht po i marrim propozimet; grupi i Aleancës?

Besë Bytyqi – Ky komision është formuar para disa seancave dhe propozimi ynë ka qenë Arbër Zenuni, gjithashtu edhe në këtë seancë për këtë komision është i njëjti.

Merisa Sharku – Ne propozojmë Ilir Pallqën.

Burim Krasniqi – Lidhja demokratike e propozon Eqerem Spahiun.

Bejtullah Deliu – Ne si PDK nuk kemi propozim.

Kryesuesi - Faleminderit shumë për mirëkuptimin, atëherë anëtarët e kuvendit komunal të deleguar në komisionin për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve janë; Arbër Zenuni – AAK, Ilir Pallqa – VV, Eqrem Spahi – LDK dhe 2 anëtarët e ekzekutivit janë Djellza Çanta dhe Jetmir Ukaj. Po e vendosim në votim këtë pikë të rendit të ditës; para kësaj është një keqkuptim këtu, anëtarët e propozuar nga ekzekutivi i komunës, po e lejmë që edhe për këtë komision t'i vendosin emrat më pas, sepse ka keqkuptime, shërbuesit civil nuk kanë të drejtë të jenë pjesë në këtë komision...

Burim Krasniqi – Në çoftëse mund të n'a shpjegoj zyrtari ligor, si janë të ekzekutivit e jo të shërbimit civil dhe a duhet të jenë drejtor, të kabinetit të kryetarit apo çfarë formati? ...

Mirsad Shala – Faleminderit, përshëndetje për të gjithë, përpos komisionit që është formuar për vlerësimin e kontratës për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës që kanë qenë dy nga shërbyesit civil, kam qenë unë si përfaqësues i zyrës ligjore dhe si arkitekte Djellza Çanta, në të gjitha komisionet tjera që janë formuar prej kuvendit kanë qenë nga ekzekutivi dhe përfaqësues nga kuvendi, nuk ka patur tjerë.

Kryesuesi – Faleminderit Mirsad, po e vendosim në votim këtë komision dhe emrat do të vendosen më pastaj nga ekzekutivi i komunës. Kush është për?...kundër?...Abstenim?... Atëherë me shumicë votash aprovohet edhe kjo pikë e rendit të ditës me përbërjen e cekur më lartë.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik pjesën e P-71510057-0234-2 në zonën kadastrale Rahovec;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, kolegë drejtor, anëtarë të kuvendit. Para jush keni vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të parcelës 2034-2 bëhet fjalë për zonën kadastrale në Rahovec me pronar Sylejman Halit Durguti, pjesa e përgjithshme e parcelës është 32ari e 0.5m katror, kërkojmë prej juve që interes të përgjithshëm t'a shpallim vetëm pjesën e kësaj parcele në sipërfaqe prej 64m katror me qëllim dhe interes për hapjen e rrugës që kemi pasur shumë kërkesa prej fermerëve dhe kemi ra në ujdë me pronarin e kësaj parcele për shpallje në interes të përgjithshëm dhe në faza tjera të bëhet edhe këmbimi për hapje të rrugës. Sipas PZHK kjo pjesë e parcelës gjendet brenda zonës ndërtimore dhe për punë tjera të kësaj parcele do të kujdeset drejtoria e gjeodezisë, kadastrës dhe pronës.

Ilir Pallqa – Përshëndetje, një pyetje shkurt; këmbimi do të bëhet brenda asaj parcele apo diku tjetër, në kufi me parcelën në fjalë? E keni paraparë?

Afrim Oruqi – Nuk e di, sa po na ndihmon projektori, bëhet fjalë për parcelën që shihet, kjo e gjata është vreshtë, përballë në hyrje të Rahovecit në anën e djathtë përballë është një autolarje që pastohen disa tepih aty, kjo që shihet n'a ndihmon më shumë me vija të kuqe aty ku është mausi tani, këtë parcelë po e shpallim interes të përgjithshëm, në seancat tjera do të kërkojmë prej juve pëlqim për këmbim. Këmbimi do të ndodh brenda kësaj parcele, vetëm në drejtim të kufirit.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor,... po e vendosim në votim; kush është për?...kundër?...abstenim?... Atëherë me shumicë votash aprovohet kjo pikë e rendit të ditës, kalojmë te pika tjetër;

6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P-71510057-05864-0 zona, në kadastrale Rahovec;

Afrim Oruqi – Të nderuar anëtarë, bëhet fjalë për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër sipas ligjeve të aplikueshme, kërkesë për shfrytëzim prej 15 viteve, prona është e komunës së Rahovecit parcela 5864-0 në sipërfaqe prej 20 ari e 31m katror, qëllimi i dhënies në shfrytëzim i kësaj parcele është për bujqësi dhe për blektori si dhe mundësi që qytetarët të vetpunësohen. Parcela sipas PZHK ka destinim si tokë bujqësore të klasës së bonitetit të tretë. Kërkojmë prej juve miratim për dhënien në shfrytëzim të kësaj parcele në afat prej 15 viteve.

Kryesuesi - Faleminderit drejtor, a ka ndonjë pyetje?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim; kush është për?... kundër?... abstenim?... Atëherë me shumicë votash "për" aprovohet edhe pika e gjashtë e rendit të ditës, vazhdojmë me pikën e shtatë;

7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P- 71510057-05864-0 zona, në kadastrale Rahovec;

Afrim Oruqi – Para jush keni vendimin për formimin e komisionit për e procedurave për vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës të paluajtshme të komunës, bëhet fjalë për të njëjtë parcelë që biseduar më herët që morëm vendim për dhënien me qira parcelën me nr.5864-0, komisioni përbëhet prej 5 anëtarëve, 2 anëtarë nga ekzekutivi 2 kuvendi dhe një anëtar prej sektori joqeveritar. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij komisioni janë; shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktojnë çmimin fillestar, kushtet, kreteret e ankandit publik dhe punët tjera të parapara me ligj.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, atëherë edhe ky komision përbëhet prej 5 anëtarëve, 2 janë nga ekzekutivi i komunës, Berat Duraku, Erhan Morina, dy përfaqësues nga kuvendi komunal që do t'i zgjedhim tani dhe një përfaqësues nga sektori joqeveritar. Meqenëse PDK është tërhequr më parë, po i japim përparësi tani, nëse kanë propozim për anëtar të këtij komisioni.

Bejtullah Deliu - Faleminderit kryesues, pasiqë jemi kaq tolerant në mirëkuptim ne propozojmë Ellma Hamzën.

Kryesuesi – Faleminderit Bejtullah, duhet edhe një propozim prej 3 grupeve të tjerë të asambleistave.

Besë Bytyqi – Faleminderit kryesues, nuk e kuptova arien pse i dhe përparësi grupit të LDK-së, sidoqoftë në rregull, grupi i aleancës si grupi më i madh në këtë kuvend komunal, propozon Feriz Thaqin.

Sinan Kryeziu – Përshëndetje kryesues, ne si grupi më i madh opozitar që jemi këtu në sallë, heqim dorë prej këtij komisioni, por propozojmë nga radhët e LDK-së bashkëvendasin tim nëse ka interes, Burim Krasniqin.

Burim Krasniqi – Faleminderit Sinan, por propozohemi edhe vet, nuk e kemi telashe. Kur janë komisionet, meqenëse prej ekzekutivit janë përfaqësues drejtorat, që nënkupton direkt politikisht përfaqësohet aleanca në komisione, besoj që aleanca duhet të kursehet në komisione për shkak se përfaqësohet. Nëse e vendosim edhe ne një emër duhet t'i fusim në votim një nga një duke e shikuar arsyen pse e bejmë është e kot. Megjithatë LDK nuk ka propozim për këtë komision.

Kryetari – Drejtorat kanë qenë të parties, por tani janë bërë të komunës, por nuk është keq, Ferizi ka një përvojë dhe ma merr mendja që është edhe më i gjallë, përndryshe këto janë çështje më shumë të kuvendit sepse ekzekutivi më shumë e ka rolin e menaxhuesit të procesit.

Kryesuesi – Faleminderit Burim dhe kryetar. Atëherë komisioni e ka këtë përbërje; Prej kuvendit delegohet Ellma Hamza dhe Feriz Thaqi dhe një përfaqësues nga sektori joqeveritar do të plotësohet pas ftesës që i bëhet nga komuna, po e vendosim në votim këtë komision me këtë përbërje; kush është për?... Me shumicë votash miratohet edhe pika e shtatë e rendit të ditës.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik P- 71510021-00010-1 dhe P-71510021-00010-2, në zona kadastrale Dobidol;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, bëhet fjalë për parcelat në zonën kadastrale në dobidol, vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër, pronar i këtyre dy parcelave me nr. 10-1, 10-2 është komuna e Rahovecit, kërkojmë prej juve pëlqim që këto dy parcela 10-1 (me sipërfaqe; 89ari e 16m katror) kërkojmë nga ju që të marrim vendim vetëm për pjesën e parcelës në sipërfaqe prej 69ari e 16m katror, d.m.th mbesin 20 ari sepse atje në këtë zonë në dobidol një pjesë e kësaj parcele të përgjithshme shfrytëzohet si rrugë prej komunitetit. Për parcelën me nr. 10-2 e cila është në zonën e njejtë kadastrale me sipërfaqe të përgjithshme prej 25ari, kërkojmë prej juve që të marrim vendim për pjesën me sipërfaqe prej 18 ari e 80m katror sepse 6ari e 2m katror sepse këto dy parcela janë në kufi me njëra tjetrën, në të njëjtën zonë dhe shfrytëzohet për rrugë. Qëllimi është që qytetarët të vetpunësohen kur t'i marrin me qira parcelat. Sipas PZHK-së këto dy parcela janë tokë bujqësore me klas të bonitetit të tretë. Kërkojmë që të merret vendimi që të jepen në afat prej 15 viteve. Këto parcela pasi që të kalojnë në procedura ligjore nuk mund t'i jepen personit të tretë në shfrytëzim e as nuk mund të tjetërsohen.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, nëse nuk ka dikush diçka rreth kësaj pika, atëherë po e vendosim në votim; kush është për?... Me shumicë unanime aprovohet edhe pika e 8-të e rendit të ditës.

9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P- 71510021-00010-1 dhe P-71510021-00010-2, në zona kadastrale Dobidol;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të kuvendit, para jush e keni vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave për vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave për shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 vite të parcelës me nr. 10-1 , 10-2, komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi

përbëhet prej 5 anëtarëve, 2 nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe 1 nga sektori joqeveritar. Detyrat dhe përgjegjësit e këtij komisioni janë; shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, caktojnë çmim, caktojnë kushte dhe kritere tjera të ankandit publik gjithmonë në bazë të ligjeve dhe akteve tjera nënligjore. Ftoj anëtarët e kuvendit që të votojnë këtë vendim.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues. Drejtor, pra ky komision do t'i vlerësoj dy parcela për shfrytëzim?... a është konflikt interesi, a kemi bazë ligjore?...

Afrim Oruqi – Në pyetjen e kuvendarit, nuk ka konflikt, nuk ka telashe, bëhet fjalë për të njëjtën zonë, të njëjtat kërkesa të fermerëve. Parcelat janë në kufi me njëra tjetrën, jemi në rregull me ligjin, gjithashtu e kemi këtu përfaqësuesin e zyrës ligjore i cili mund të më plotësoj.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, dikush tjetër?... Nëse jo, atëherë po i marrim propozimet prej anëtarëve të kuvendit, ky komision përbëhet prej 5 anëtarëve; dy anëtarë nga ekzekutivi; Berat Duraku, Afrim Oruqi. I ftojme grupet e asambleistave për propozime, grupi i Aleancës e ka përparësinë;

Besë Bytyqi – Faleminderit shumë për korrektësinë, grupi i Aleancës u jep përparësi partive opozitare, nëse nuk kanë propozime ne në fund vazhdojmë me propozimin tonë.

Merisa Sharku – Faleminderit për nderime, ne si vetëvendosje propozojmë Leonard Morinën.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues, ne si LDK nuk kemi propozim.

Bejtullah Deliu - I nderuar, ne si PDK propozojmë Sejfullah Sejfullahun.

Kryesuesi – Faleminderit, atëherë 4 përfaqësues, 2 nga ekzekutivi dhe Leonard Morina gjithashtu Sejfullah Sejfullahu nga kuvendi i komunës, atëherë po e vendosim në votim këtë komision me këtë përbërje; kush është për?... Me shumicë unanime aprovohet edhe pika e 9-të e rendit të ditës, vazhdojmë me pikën e 10-të.

10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.337/22, i datës: 29.06.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës;

Erhan Morina - I nderuar kryesues, nënkryetar, të nderuar drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit, media dhe ju të pranishëm. Para jush keni materialin për shfuqizimin e vendimit me nr. 337/22 të datës 29.06.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme te depot, te matreksi në Xërxë. Arsyeja për shfuqizimin e këtij vendimi është sepse 2 nga 4 këto parcela nuk kanë kaluar ligjshshmërinë dhe ne si drejtori e kemi parë të arsyeshme që ta shfuqizojmë komplet vendimin me qëllim që në janar të vitit t'i fusim të 4 parcelat në vendim dhe t'i japim në shfrytëzim, poashtu me këtë vendim lidhet edhe vendimi për krijimin e komisionit, kërkoj nga ana e kuvendit gjithashtu shfuqizimin e komisionit që është krijuar për vlerësimin e këtyre ofertave.

Burim Krasniqi – Edhe në një seancë më herët e kam cekur të njëjtën çështje, kur ka propozim për shfuqizim të vendimit, përpos propozim vendimit duhet të jetë edhe arsyetimi, pse e ka kthyer ministria, shkresën e ministrisë, emailin etj... Delegatët e kuvendit t'a shohin arsyen e shfuqizimit të një vendimi që është marrur dje.

Kryetari – Ka të drejtë plotësisht Burimi. Unë besoj që Erhani dhe të tjerët opinionin e departamentit ligjor të ministrisë së pushtetit lokal apo edhe ndonjë ministrie tjetër për arsyet pse duhet të shfuqizohet një vendim i marrur nga kjo asamble, duhet t'a shoqëroj me këtë arsyetim. Përndryshe arsyetimi është i çartë dhe e dini edhe ju pse po ndodh kjo. Realisht ndonjëherë prej përpjekjes që të bëjmë më shumë punë, ka pakujdesi ose mungesë fokusi edhe nga ana jonë. Psh; nëse dëshirojmë të japim në shfrytëzim diçka për vitin e ardhshëm, sivjet duhet të parashihet dhe kjo në këtë rast n'a ka ikur neve, normal që ata nuk t'a falin dhe ta kthejnë dhe jemi të obliguar për shfuqizim.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar, nëse nuk ka dikush diçka...? Atëherë po e vendosim pikën e 10-të në votim, kush është për?... Me shumicë votash unanime aprovohet shfuqizimi i vendimit nr.337/22. **11.**

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.339/22, i datës:

29.06.2022 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale. Kush është “për” shfuqizimin e komisionit?... Me shumicë unanime miratohet edhe ky vendim për shfuqizimin e vendimit nr.01339-22. Kështu po përmbyllet rendi i ditës për ditën e sotshme, para se t’a përfundojmë, e kam një njoftim që materiali fizik nuk do të dërgohet më për anëtarët e kuvendit komunal, meqenëse jemi pajisur me laptop-a dhe nuk besoj që është e nevojshme që të dërgohet materiali fizikisht, poashtu e kam edhe një falënderim për zyrën e IT, zyrën e kuvendit si dhe zyrën ligjore, të cilët përkundër që janë duke e shfrytëzuar një të drejtë ligjore (greva), n’a kanë ndihmuar sot t’a mbajmë seancën me rregull sipas planit tonë. Faleminderit, mirëmbetshi .

01 Nr..371/22

Data:23.09.2022

Procesmbajtësi:

Skender Hamza

